UDHËZIM
Nr. 4, datë 14.4.2014

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 199, DATË 2.4.2014 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 480, DATË 22.6.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MODEL TË PLANIFIKIMIT", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 22.6.2011 "Për miratimin e rregullores model të planifikimit", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 944, datë 9.10.2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit", si dhe në zbatim të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 2.4.2014 të Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa në vendimin nr. 480, datë 22.6.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores model të planifikimit", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në përputhje me nenin 4 të shtojcës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 22.6.2011 "Për miratimin e rregullores model të planifikimit", të ndryshuar, duhet të shprehet mbi kërkesat për kontrollin e përputhshmërisë me instrumentet kombëtare dhe/ose vendore të planifikimit, të miratuara ose në proces, për të gjitha zhvillimet që kërkohet të kryhen, përfshirë dhe në zonat e pezulluara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT).
2. Autoritetet e planifikimit të territorit, përpara shqyrtimit të kërkesave për zhvillim, dhe si kusht për dhënien dhe ligjshmërinë e lejeve zhvillimore për kategoritë e përmendura në pikën 1, germat "a", "b", "c" dhe "d", të nenit 4 të shtojcës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 22.6.2011 "Për miratimin e rregullores model të planifikimit", të ndryshuar, përfshirë dhe në zonat e pezulluara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit, kanë detyrimin të kërkojnë paraprakisht konfirmim nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për përputhshmërinë e zhvillimit që propozohet për t'u kryer me instrumentet e planifikimit, të miratuara ose në proces, përfshirë me politikat e strategjitë sektoriale, kombëtare apo vendore.
3. Për marrjen e konfirmimit nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, autoritetet e planifikimit të territorit dhe/ose zhvilluesit duhet të paraqesin, të paktën:
-kërkesë për kontrollin e përputhshmërisë;
-vërtetimin nga regjistri i pasurive të paluajtshme dhe planvendosjen e pronës ku propozohet të kryhet zhvillimi;
-projektin zhvillimor, kur të evidentohen treguesit e zhvillimit;
-hartën e përdorimit ekzistues të tokës në një rreze 1.5 km nga zhvillimi i propozuar.
4. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, me marrjen në dorëzim të kërkesës si më sipër, shqyrton përputhshmërinë e zhvillimit të propozuar me instrumentet kombëtare dhe/ose vendore të planifikimit, të miratuara ose në proces, dhe bashkërendon veprimet me autoritetet e tjera të planifikimit. Pas shqyrtimit, përgatit informacionin përkatës dhe vë në dijeni Këshillin Kombëtar të Territorit.
5. Njoftimi për Këshillin Kombëtar të Territorit bëhet nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në dy mënyra. Njoftimi bëhet në mbledhjen e radhës së Këshillit Kombëtar të Territorit ose me anë të njoftimit të anëtarëve dhe kryetarit sipas procedurës dhe njoftimit të tyre si në rastin e njoftimit për mbledhjet e KKT-së.
6. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit shprehet brenda 30 ditëve nga marrja në dorëzim e kërkesës për kontrollin e përputhshmërisë.
7. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.
8. Pas hyrjes në fuqi të tij, udhëzimi publikohet në portalin e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni